

E kaluara e manastirit Mëglizh është e mbështjellë në mister



Një nga manastiret tona më të bukura është i heshtur në thellësitë e Ballkanit, 2 kilometra në veri nga qyteti i rrethit Mëglizh. Shumë pak janë njerëzit që vijnë këtu larg qendrave tona turistike të përmbushura me njerëz, që të vetmohen dhe të marrin një gllënjë shpirtërore larg kotësisë njerëzore.

Manastiri i Mëglizhit “Shën Nikollaj” i pret vizituesit e vet me qëndrimin krenar të kishës së vet me një nef, e ngritur në vendin e kishës së mëparshme ortodokse, mbeturinat e së cilës janë të shpërndara në afërsi.

Pavarësisht se është i rinovuar dhe i mirëmbajtur shumë mirë, manastiri nuk ka humbur asgjë nga patina e kohës dhe atmosfera e cila transmeton qetësi dhe shenjtëri. Ndërtesa të bukura në stilin rilindës e rrethojnë anë e mbanë oborrin e zhytur në lule. Derisa shëtisni nëpër çardakët prej druri të cilët kërcasin nën këmbët tuaja, do të shijoni pa fund pamjet e bukura drejt majave të kundërta malore. Por, çfarë dimë për historinë e këtij vendi të përmbushur me shumë shpirtmadhësi dhe shenjtëri? Del se shumë pak!

Historianët janë të një mendimi për një gjë se në kohërat me të trazuara e të turbullta të Sundimit Osman, Manastiri i Mëglizhit ka ruajtur shpirtin dhe frymën

bullgare dhe besimin e krishterë. Dhe se akoma gjatë shekullit të 16 këtu janë përgatitur priftërinjtë për të gjithë Bullgarinë Jugore. Sipas burimeve të shkruara, gjatë vitit 1623 udhëheqësi jeniçer Skllav mbërrin në Mëglizh, për të mbledhur “taksën e gjakut”. Të frikësuar, njerëzit kanë fshehur fëmijët e vet në manastir. Dhe me qenë se murgjit nuk i kanë tradhtuar, për dënim manastiri është djegur, kurse murgjve u kanë prerë kokat. Dusho Gavazov , zëvendës-kryetar i bashkisë së Mëglizhit tregon:

“Rinovimi i manastirit bëhet midis viteve 54-69 të shekullit të 20. Atëherë ai është rikonstruktuar dy herë dhe i rinovuar krejtësisht. Sipas të dhënave letrare, gjatë periudhës së Rilindjes këtu është hapur shkolla e meshkujve, kurse disa vjet më vonë dhe ajo e femrave. Gjatë vitit 1870 shkolla zhvillohet në shkollë të mesme. Përveç kësaj në manastir ka pasur një bibliotekë jashtëzakonisht të pasur. Mjerisht pjesa më e madhe e arkivit është djegur gjatë kohës së Luftës Çlirimtare Ruso-Turke gjatë periudhës së viteve 1877-78. Supozohet se këtu jo njëherë ka ardhur dhe ka qëndruar Apostulli i Lirisë Vasill Levski.”

Në ditët tona qelia e Levskit, si dhe shkolla me qeli janë të rivendosura. “Në kishë ekziston diçka, të cilën nuk e gjejmë në asnjë vend tjetër në Evropë. Bëhet fjalë për një ikonografi, në të cilën janë paraqitur bashkë Vëllezërit e Shenjtë Kirill dhe Metodij dhe Shën Patrik – i cili është mbrojtësi dhe përkrahësi i Irlandës” – thotë Dusho Gavazov.

Sipas legjendës vendase afresku i pazakontë ka qenë i porositur dhe i pikturuar me dhurime të një irlandezi të panjohur. Kurse studiues shpjegojnë ekzistencën e tij me faktin se që të tre shenjtorët kanë regjistruar emrat e vet në historinë e qytetërimit evropian, duke kryer misione të ngjashme. Shën Patrik ka jetuar gjatë shekullit të 5dhe ka sjellë krishterimin mes popujve të veriut. Katër shekuj më vonë vëllezërit e Selanikut përkthejnë Biblën në gjuhën bullgare të vjetër dhe shpërndajnë fjalën e shkruar mes sllavëve dhe bullgarëve.

Dhe akoma një gjë tjetër bën përshtypje – nënjë pjesë prej pikturës së shenjtorëve bullgarë në zbukurimin mural të kishës, ata janë me veshje popullore.